

UDHËZIM Nr.26, datë 2.12.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Paragrafi pas shembullit të dytë të pikës 6.2 “Furnizimi i shërbimeve nga jashtë vendit”, me përmbajtjen: “Personi i tatueshëm jorezident në Shqipëri, i cili kryen shërbime, vend i furnizimit të të cilave është në Shqipëri dhe për rrjedhojë detyrimi për të paguar TVSH-në lind në Shqipëri, në zbatim të nenit 55 të ligjit, i kërkohet të emërojë përfaqësuesin e tij tatimor. Detyrimi i personit të tatueshëm jorezident, për t’u regjistruar me anë të një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në në Shqipëri, zbatohet pavarësisht nëse vlera e furnizimit të shërbimit kalon ose jo kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar.”, zhvendoset në fund të pikës 6.1 “Shërbime të lidhura me pasurinë e paluajtshme”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Botuar ne F.Zyrtare 165 / 2011
Dale nga shtypi me 23.12.2011